



Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 4. 5 të Ligjit nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 3.1 Rregullës Zgjedhore nr. 15/2013 për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme dhe Zgjedhjet e Parkohëshme, si dhe duke bazuar në vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës të datës 11.05.2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e mbajtur me datën 11.05.2017, nxjerrë këtë:

Vendim

Për Caktimin e Afateve të Aktiviteteve Zgjedhore sipas Rregullës Zgjedhore nr.15/2013 për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme dhe Zgjedhjet e Parakohëshme

- I. Miratohet vendimi për caktimin e afateve të aktiviteve zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës, të cilat do të mbahen më 11 qershor 2017.
- II. Afatet kohore për zbatimin e të gjitha aktiviteteve zgjedhore që ndërlidhen me zgjedhjet e parakohshme, i referohen afatit prej 31 (tridhjetë e një ditë) ditë, si në vijim:
 - a) *Deklarimi për mospjesëmarrje në zgjedhje i Partive Politike do të filloj më 11 maj dhe do të përfundoj më 15 maj 2017*
 - b) *Afati për krijimin e Listës së Votuesve, periudha e kundërshtimit dhe konfirmimit do të filloj më 25 maj dhe do të përfundoj më 28 maj 2017.*
 - c) *Deklarimi për koalicione të Partive Politike do të filloj më 11 maj dhe do të përfundoj më 16 maj 2017*
 - d) *Tërheqja e Subjekteve Politike do të filloj më 24 maj dhe do të përfundoj më 25 maj 2017.*
 - e) *Aplikimi i subjekteve politike dhe kandidatëve do të filloj më 11 maj dhe do të përfundoj më 19 maj 2017.*
 - f) *Periudha për paraqitjen e përmirësimeve/korrigjimeve nga SP do të filloj 17 maj dhe do të përfundoj më 22 maj 2017.*
 - g) *Certifikimit i subjekteve politike dhe kandidatëve do të filloj më 19 maj 2017 dhe do të përfundoj më 23 maj 2017.*

- h) Afati i shorti të fletëvotimit, do te mbahet me 27 maj 2017.*
 - i) Afati i fundit për tërheqje të kandidatëve nga shorti i fletëvotimit dhe afati i zëvendësimit të kandidatëve 24 maj 2017*
 - j) Publikimi i listave të kandidatëve të certifikuar dhe më çfarëdo ndryshimi do të bëhet më 23 maj 2017.*
 - k) Afati për të caktuar kufizimin e shpenzimeve për fushatë fillon me 11 maj dhe mbaron me 15 maj 2017.*
 - l) Fushata Zgjedhore si dhe afatet për tubimet zgjedhore do të fillojnë më 31 maj dhe do të përfundojnë më 9 qershor 2017.*
 - m) Dorëzimi i kërkesës për akreditimin e organizatave për vëzhgimin e zgjedhjeve dhe vëzhgueseve do të fillojë më 11 maj dhe do të përfundojë më 4 qershor 2017.*
 - n) Emërimet e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve (KKZ) do të bëhet më 18 maj 2017.*
 - o) Periudha e shërbimit të votuesve do të fillojë më 20 dhe do të përfundojë më 28 2017.*
 - p) Certifikimi i listës së votuesve do te bëhet me 1 qershor 2017.*
 - q) Emërimet e Këshillave të Vendvotimeve do të fillojnë më 27 maj dhe do të përfundojë më 29 maj 2017.*
 - r) Publikimi i Qendrave të Votimit do të bëhet më 15 maj 2017.*
 - s) Aplikimi për regjistrim si votues jashtë Kosovës do të fillojë më 15 maj dhe do të përfundojë më 22 maj 2017.*
 - t) Periudha e kundërshtimit dhe e konfirmimit do të fillojë më 25 maj dhe do të përfundojë më 28 maj 2017.*
 - u) Aplikimi për regjistrim si votues me nevojë të veçantë do të fillojë më 25 maj dhe do të përfundojë më 28 maj 2017.*
- III. Caktimi i afateve sipas neni I të këtij vendimi, do të vlejë për Zgjedhjet e parakohëshme për Kuvendin e Kosovës, që do të mbahen më 11 qershor 2017 .

IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nëshkrimit.

Prishtinë, 11 maj 2017

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve



Valdete Daka